


VITI XIV, NUMRI 8 / GUSHT 2010

# FOREVER



HUNGARY | ALBANIA | BOSNIA AND HERZEGOVINA | CROATIA | MONTENEGRO | SERBIA | SLOVENIA



DENVER



COLORADO



12-14. GUSHT 2010.



# BËJE DITËN E SOTME DITËN E *Forever-it*'!

**G**jatë rrugës sime të fundit e cila përfshiu Hungarinë, Turqinë dhe Gjermaninë, u çudita përsëri që sa efekt të madh ka FOREVER në jetën e njerëzve. Kur bashkë me Aidan-in në Success Day-n e Budapestit u takuam me më shumë se 12000 miq, më preku thellë ndjenja që sa mundësi të shumta sjell biznesi FOREVER në jetën e njerëzve. Dhe m'u krijua pa dyshim bindja që duhet ta vazhdojmë përhapjen e mesazhit të shëndetit, pasurisë dhe lumturisë në botë.

Kjo rrugë më kujtoi edhe se gjatë jetës sonë marrim pjesë në prova dhe goditje të ndryshme, ashtu si edhe në suksese dhe lumturi. Pothuajse gjatë gjithë muajit të kaluar në Europë ra vazhdimisht shi. Gjatë bisedave tona dilte gjithmonë tema e motit të tmerrshëm. Pas fjalëve ndihej që ky problem ka efekt serioz në jetën e përditshme të njerëzve. U thashë atyre njerëzve të dashur që megjithëse nuk mund të ndikojmë dot mbi motin, mund të kemi efekt ndaj mënyrës se si e përballojmë këtë problem. Me gjysëm shaka thashë që „mos u shqetësoni, unë kudo që shkoj, sjell me vete diellin”.

Europianët në këtë periudhë me shira i harruan ditët me diell, ashtu si edhe njerëzit të cilët në periudhat e vështira e harrojnë lumturinë që kishin më parë. Jeta mund të jetë me të vërtetë e pamëshirshme. Por prapë është plot me shpresa dhe mundësi nëse nuk dorëzohemi, nëse përpiqemi të shikojmë të mirën, u vendosim theksin mendimeve pozitive.

Në Arizonë përshembull mbizotëron dielli, prandaj ne vlerësojmë më shumë pikërisht ditët me shi. Mënyra jonë e të menduarit ndoshta ndryshon vetëm në faktin që ne nuk lejojmë që të na sundojnë rrethanat. E konsiderojmë më të rëndësishme reagimin ndaj tyre, për këtë përqendrohemi. Natyrisht e di që nuk është e lehtë të përballosh tragjeditë e jetës. Por di edhe që qëndrimi është vendimtar, dhe kontribon shumë në zgjidhjen e një problemi. Edhe Edgar A. Guest këtë përpiqet të na shpjegoj në vjershën e tij me titull Things work out.

Tregohu i hapur. E di që ka situata që ta heqin qejfin. Pengesat që të dalin përpara, kur duhet kohë, durim dhe shumë këmbëngulje që të zgjidhen gjërat. Por më beso, që më në fund dielli ndriçon, dhe bota zgjohet në një mëngjes të mrekullueshëm. Edhe ti çon diellin kudo që shkon. Ti vendos. Çdo ditë kur zgjohesh kujto të mirat e mrekullueshme të jetës tënde dhe faktin që edhe ti je pjesë e mundësisë më fantastike të botës. Vendos që ditën e sotme ta bësh ditën e FOREVER-it.



*Rex Maughan*

REX MAUGHAN





## „Ëndërrova NJË BOTË PËR VETEN TIME”

(Attila Pataky)

**S**ë shpejti festojmë themelimin e shtetit tonë i cili natyrisht është vendimtar në historinë dhe jetën e një populli. Ndërkohë që përgatitemi për festë në Denver ka filluar Super Rally i Forever-it dhe ceremonia e dhënies së çmimeve, ku themeluesi i Shoqërisë sonë, drejtuesi i përgjithshëm Rex Maughan falenderon përfaqësuesit e 145 shteteve për rezultatit vjetor. Me këtë edhe ai ka themeluar një shtet ndërkombëtar, Komunitetin Forever Living Products International. Çfarë parimesh e udhëbeqin këtë njësi fantastike? Cilat janë forcat që bashkuan më shumë se dhjetë milion njerëz në gjithë botën?

Natyrisht idea e përbashkët, misioni i drejtuesit tonë të përgjithshëm Rex Maughan, misioni i Forever-it, mundësitë e pafund dhe përcjellja e idesë së pavarësisë. Çfarë do të thotë kjo në të vërtetë? Si pasqyrohet kjo në jetën e përditshme të shtetasve të Forever-it?

Pikësynimi në radhë të parë është përjetimi i jetës së ekuilibruar që bazohet në pavarësinë materiale. Njëlloj i rëndësishëm është edhe realizimi i jetës së shëndetshme, pa stres, respekti i vlerave pozitive dhe mësimi i marrdhënieve të pastra njerëzore.

Rex Maughan e shprehu shumë thjeshtë moton e tij. Forca e Forever-it është forca e dashurisë. Në të vërtetë njeriut mund t'i drejtohem vetëm me dashuri. Në mënyrë që t'i ofrojmë ndihmë nëse i lëkundet besimi në të ardhmen. Nëse bashkohet me ne, atëherë e marrim për dore dhe e udhëbeqim në rrugën e cila jo vetëm për të, por për gjithë familjen e tij, madje për gjithë gjeneratat e ardhshme ofron një stil jete, qëllim dhe realizim.

T'u kushtojmë vëmendje fjalëve të Rexit dhe të kemi besim tek energjia e madhe që fshehet tek ne dhe punonjësit tanë! Nëse jemi në gjendje t'i çlirojmë këto energji fillimisht nga vetvetja, ta mësojmë këtë profesion të bukur, atëherë thjeshtë duke përcjellë njohuritë tonë u ofrojmë mundësi të mëdha miliona njerëzve. Krijojmë një shtet të ri. Shtetin – Bota e Forever-it. Pjesë e kësaj jemi edhe ne, njerëzit që jetojmë këtu, në rajonin qendror dhe juglindor të Europës. Të bëhemi çdo ditë pjesë e kësaj mrekullie që kjo botë siguron për ne, të marrim guximin të hyjmë në këtë sistem, të shfrytëzojmë mundësitë dhe të shijojmë frytet dhe kënaqësitë e tij.

Përpara FLP Shqipëri, përpara Shqiptarë!

DR. SANDOR MILESZ  
DREJTOR GJENERAL



# Shpërblim

HOLIDAY RALLY, POREÇ, 24-27 KORRIK 2010

**Çfarë fiton njeriu po ta gjej misionin e jetës së tij? Në disa firma vlerësim. Tek një tjetër shumë para. Tek një e tretë shoqëri të mirë. Diku dy prej këtyre, ose në raste të rralla edhe të treja. Por ndoshta ekziston vetëm një firmë e cila mund t'i japë të treja dhe i kurorëzon të gjitha me një rrugë falas katër ditore në bregdet – me leksione që sjellin miliona. Kjo është FLP Hungaria dhe Holiday Rally në Poreç.**

Çfarëdo të ndodh, do të bëhemi të parët në botë! Me këtë skuadër duhet të krijojmë diçka të madhe. Një gjë është e sigurt: jam i sigurt që do na mbështesni! Edhe po mos ta themi, mund ta gjejmë se kush i thotë në mikrofon fjalët e mësipërme. Dr. Sandor Miliesz e motivon skuadrën e tij në darkën e nxehtë të Poreçit. Jashtë po ngriset, landerat dhe palmat freskohen në mbërmje, por dritaret e një salle ndriçojnë për një kohë të gjatë: po jepen udhëzimet në darkën e fundit përpara zbulimit të njohur hungarez, Holiday Rallyt. Rreth tryezës ndodhen koka të mëdha. Berkics, Vagasi, Biro, Halmi dhe të tjerët të cilët nesër do të dalin në skenë, por tani ndjekin me vëmendje një person tjetër, po flet drejtori gjenral – tani sigurisht, mes njëri tjetrit e quajnë vetëm Sandor. - Jemi këtu – thotë ai – për të plotësuar kërkesat e mëdha të atyre që kanë ardhur, që janë kualifikuar në këtë program i cili quhet Holiday Rally. Tek ju janë të gjitha shpresat. Të gjithë e bëjnë për vete biznesin, por ato pak gjëra plus i jepni ju gjatë këtyre dy ditëve. Jeni gati për këtë? - Po – dëgjohet pohimi, por thuhet menjëherë kritika e zakonshme: „ju lutem, kjo s'ishte gjë fare”. Dr. Miliesz e quan të dobët edhe përpjekjen e mëpasshme, por siç thotë „më vonë do të forcohet”. - Udhëtojmë në botë dhe shikojmë që në asnjë vend nuk janë më të mirë se ne, përkundrazi nuk ekzistojnë mësues të tillë, atëherë përse do na ftonin ne – shumë e thjeshtë. Me cilët ta fillojmë? Në radhë të parë





me veten tonë. Të fillojmë të luftojmë – dëgjohet fjalëkalimi që nis këto dy ditë radhën e leksioneve më të mira. Skuadra elitë bie në gjumë: ngrihen herët në mëngjes dhe me autobusa shkojnë në sallën e teatrit e cila për dy ditë me radhë është e Forever Living Products – e më të mëdhenjëve të saj. Duhet të bëhemi të parët, duhet të bëhemi të parët – tingëllon akoma në kokën tonë gjatë gjithë rrugës deri në bregdet. E ndjejmë që gurët gëlqeror reflektojnë nxehtësinë mediterrane të mbledhur gjatë ditës kur na shfaqet përpara porta e hotelit me katër yje, pas aulës të të cilit shihet veranda e shtuar me dërrasë, me kolltuqe të thurura dhe bar kokteili, me parkun e gjelbër dhe pishinë, dhe pas gjithë këtyre deti i madh i kaltër. Magjepsemi nga



**Andrej Kepe,**  
**drejtori i FLP Sllovenisë:**

“Këto dy ditë kanë rëndësi të madhe për njerëzit e rinj. Dëgjojnë lektorë të cilët nuk kanë gjithmonë mundësi t’i dëgjojnë drejtpërdrejt. Kjo ka vlerën e një shkollë të mesme Forever! Nuk është e thjeshtë të hysh, këtu bëhet fjalë për fillestarë të cilët duhet të kuptojnë se çfarë është kjo dhe si funksionon, nevojitet pak kohë derisa ndodh ndryshimi në tru, vjen kliku: kjo është një mënyrë tjetër jetese dhe ndoshta më e thjeshtë e më e mirë se jeta ime e daritanishme.”





fakti që ndodhemi këtu, në lluksin e vërtetë. Pastaj mendojmë që ai që kualifikohet dhe vjen këtu e meriton cilësinë. Ka punuar për këtë. Dhe pas këtyre vjen gjumi. Sot s'ka argëtim, nesër na pret puna serioze dhe mësimi.

## 25 QESHOR, E PREMTE

**H**imni është i njëjtë, vetëm e këndojmë pak ndryshe – shpjegon këngëtarja Lui i emocionuar pas skenës. Shikojmë pas perdes, në publik dalëngadalë mbërrijnë të gjithë – të kualifikuarit nga pesë shtete gjejnë secili vendin e tyre në sallë. – Do të këndohet edhe Surda, kënga e sponsorëve, si dhe Treni i Dashurisë – radhit mëtej Lui duke mos pyetur për asgjë. Ndodhet prej katër viteve në firmë, u bë menaxher për tre muaj, kurse tani punon në nivelin soaring – marr vesh prej tij. Në cepin tjetër të sallës **Dia Biro** punon tek bari ku i shpjegon në mënyrë dinamike një tekniku; përgatitet me një surprizë për në Sonya show, por rreth kësaj nuk tregon më shumë. E pyes që a ke emocione? – Emocioni është diçka e mirë që është e pranishme vazhdimisht dhe nxjerr maksimumin prej njeriut. Vjen Tünde Hajcsik që të kontrolloj situatën. – Poreçi ka diçka të magjishme – thotë ajo – s'ka turmë të madhe, në këtë mënyrë ai që është kualifikuar në këtë program e ndjen që është një prej më të mirëve. Megjithëse është vetëm ora 9 e mëngjesit **Sandor Toth** kërcen në vend me muzikën në sfond. – Holiday Rally është punë apo argëtim për ty? – e pyes. – Të dyja. Ky është Forever lifestyle – thotë me shumë bindje. Të kthehemi pas skenës ku Katalin Kiraly, drejtoresha e institucioneve të Forever Resorts në Hungari, vë në lëvizje katër njerëz në mënyrë që për lektorët të ketë gjithmonë disa kafshata dhe gllënjka nëse kanë nevojë. Mbërriti një ditë më parë me skuadrën e saj në mënyrë që të sigurojnë gjithçka në dyqane. I di përmendësh dëshirat e menaxherëve. – Vjet u pëlqye shumë ëmbëlsira me qershi të tharta, por në përgjithësi skuadra ha gjithçka, u pëlqen që gatuajmë. Në sektorin VIP shihet **Dr. Terezia Samu** duke rregulluar fletët e saj. Shkruan vetëm skemën, pasi zakonisht i pëlqen të flas nga mendja. – E kam të ngritur nivelin e





adrenalinës, po mos ta kisha nuk do jepja dot një leksion të mirë. Por është në nivel të shëndetshëm – buzëqesh ajo. Është një njeri i cili nuk është aspak i shqetësuar. Ai i ka ndarë detyrat dhe nga ky moment shijon rezultatin e organizimit të bërë gjatë muajve të kaluar. – Falë Zotit punoj me profesionista, secili kryen detyrën e vet – thotë **Dr. Milesz** – kurse në sallë ndodhet gjenerata e cila përcakton të ardhmen e Forever-it. Shtresa e atyre që në të ardhmen do të bëhen menaxherë dhe të cilët tani do të trainohen nga lektorët më të mirë të botës. Por para se të fillojmë punën, kemi nevojë për një dozë të madhe energjie. E ka emrin **Tanja Zagar**: këngëtarja shumë dinamike shfaqet (hidhet, kërcen, vrapon) në skenë me grupin e saj. Ka sukses të madh, dhe pas shfaqjes duke nxituar në korridor thotë: ky është një publik i mrekullueshëm! Nuk njohin kufij!- Erdhi dita e shumëpritur, Holiday Rally i parë i 2010-ës – dëgjohet fjalia e parë nga mikrofondi i lektorëve: me këto fjalë bën hapjen zyrtare të aktivitetit Dr. Sandor Milesz. – Nëse e besoni këtu brenda, ju do të bëheni më të mirët. Por vend i parë është vetëm një, dhe duhet të bëhemi të parët. Kush dëshiron të bëhet kampion bote? Po pyes ndryshe: a jemi kampion bote? Poo! Dëgjohet përgjigjja, dhe me këtë fillon dita e cila drejtohet me një dinamikë të pashtershëm nga drejtuesit e programit **Jadranka Kraljic Pavletic** dhe **Tibor Lopicz**. A mund të jetë tjetër origjina veçse bima aloë? Mendonim se e njohim atë tërësisht, por soaring menaxherja **Dr. Revesz Edit Siklosne** na tregon shumë të reja rreth saj. Dëgjojmë jo vetëm rreth përbërësve të saj më të rëndësishëm, por edhe rreth mënyrës se si na ndihmon të mbrojmë shëndetin tonë kundër sfidave të botës së jashtme. Safir menaxheri **Dr. Endre Seres** dëshmon: - Trembëdhjetë vjet për të cilët jam shumë krenar – thotë dhe radhit shembujt e ngjarjeve dhe sukseseve. Ta vazhdoj mëtej? Po e vazhdoj! – thotë ndërmjet fjalëve të tij, dha na duket sikur mund të vazhdoj pa fund. Tema e soaring menaxheres **Dr. Terezia Samu** s'mund të jetë tjetër veçse fusha ku është më e mira: mënyra e shëndetshme e

#### **Tamas Biro, soaring menaxher:**

"Është përgjegjësi më e madhe t'u flasësh të rinjve. Sipas meje kjo e ndryshoi imazhin e Forever-it: Poreçi. Thënie e vjetër, por e vërtetë: sa më larg shkon dhe sa më shumë kushton, aq më me vlerë është informacioni. Por nëse i zbaton parimet bazë, sukcesi do të vijë me çdo kusht."



jetesës. Prej saj dëgjojmë si zakonisht paketën e lehtë, por profesioniste me të reja shkencore dhe përvoja të përditshme. Nën drejtimin e soaring menaxheres **Dr. Ilona Juronincs Vargane** vijmë me radhë përvoja me produkte, pastaj safir menaxheri Zsolt Fekete “na organizon punën”, me fjalë të tjera na tregojnë se si do e bënte ai. Pas kësaj shfaqen dhomat e pritjes: soaring menaxheri **Sandor Toth** flet rreth prezantimeve familjare në mënyrë të hollësishme dhe humoristike: është mirë t’i dëgjosh (dhe natyrisht t’i sistemosh dhe t’i mendosh nga e para) situatat e njohura për të gjithë ne. Nga safir menaxheri **Istvan Utasi** mësuam se “që tani zgjidhjen e kemi në mendjen tonë”. Nëse nuk e ndjejmë këtë më siguri, energjitë e marra nga ai na e përforcojnë besimin. E bukura e Halmit është që e fillon gjithmonë me ironi rreth vetvetes, kështu që nuk na duket se duhet të jemi të përsosur për të patur sukses. Patat e egra shkojnë 40 përqind më larg në grup në formë v-je se sa vetëm, dhe nuk lenë të dalë nga radha asnjë anëtar të grupit derisa ka shpresë për t’u kthyer – tregojnë se si është skuadra me të vërtetë e mirë. – Pesë vjet më pas do të bëhesh ashtu si janë librat që lexon dhe njerëzit që të rrethojnë – na tërheq vëmendjen safir menaxheri **Istvan Halmi**, pastaj radhit gjërat më të rëndësishme: qëllimet e përbashkëta, bashkëpunimi, angazhimi, komunikimi dhe menaxhimi i mirë. Dhe njerëzit që duan të të ndjekin. Duke e dëgjuar prej tij na duket si lojë fëmijësh. Mos pyet që çfarë merr, por tregoj çfarë u jep të tjerëve: këtë këshillë e marrim nga soaring menaxherja **Marta Zsiga**. – Forca më e madhe e magjishme është kur tregojnë vetveten. Duhet të flasësh gjithmonë me bindje dhe entuziazëm. Bëhu ti era që i ngre lart njerëzit! Pas Martës në dritën gjithmonë e më të nxehtë të reflektorit shfaqet senior menaxheri Andras Banhidy. – Edhe në shtëpi kemi një skuadër e cila ka nevojë për organizim gjithashtu. Si dhe që të na pranojnë... – thotë ai duke patur parasysht fëmijën e tij 11 muajsh dhe ditët e ndryshuara thelbësisht. Pastaj na bind me shembuj të marrë nga jeta sportive dhe historia: ky biznes ka nevojë për ne. Soaring menaxheri **Tamas Biro** mban në dorë një kristal mali, gurin e fatit me ngjyrë të gjelbër – Do ta mbaj në dorë edhe gjatë leksionit, sepse edhe unë kam nevojë për bastun – thotë duke buzëqeshur. Ai është i aftë të na tërheq vëmendjen edhe duke mos thënë asnjë fjalë. Tani pikërisht kjo ndodh: Tamas mbështetet dhe qëndron



**Jasna Kvaternik Jankovic:**

„Kam marrë pjesë në shumë aktivitete në Kroaci dhe në Hungari, por... Poreçi sjell gjithmonë diçka të re, diçka interesante. Vjet më dha një shtytje të madhe, fitova shumë përvoja, dëgjova leksione të shkëlqyera dhe u mbusha me energji pozitive.“

përpallë publikut, ndërkohë që nga altoparlatët dëgjohet kënga që depërton deri në zemër: “duhet të them edhe aq shumë gjëra”. Pastaj dëgjojmë rreth librave, rëndësisë së leksioneve dhe shtyllave stabile të cilat qëndrojnë në këmbë edhe nëse përqeshet ndërtuesi i tyre. Tamas sot nuk përqeshet nga asnjëri, përkundrazi: e duartrokasin në këmbë. Gjatë tetë viteve u bë diamant-safir, prej dymbëdhjetë viteve është anëtare e







President's Club dhe zotëron një nga çeqet më të mëdha. Nëna dhe djali i saj janë gjithashtu menaxherë, dhe sipas drejtuesit të programit **Tibor Lapicz** nuk qetësohet derisa edhe nipi i saj nuk bëhet i tillë. Në skenë shfaqet **Aranka Vagasi**. – Dëshiron të marrësh pension apo të drejtë autori? – bën pyetjen provokative, por ajo që është më e rëndësishme se kjo: – Unë vetëm nuk do e bëja dot, kam një skuadër të shkëlqyer, së bashku jemi të mirë – shton dhe pastaj thërret rreth skenës njerëzit e saj. Vjen dikush për të cilin nuk ekziston e pamundura. Diamant-safir manexheri **Attila Gidofalvi** tregon rreth rezultateve, por shton menjëherë që: “kam një lajm të keq: për këto duhet të punosh”. Dhe ai punon, tashmë prej njëzet vitesh. Puna për të do të thotë: t’u japësh njerëzve ëndrra. – E provojmë këtë, por shpeshherë pa sukses – tregon ai – është e vështirë të gesh çelësin e duhur. Por njëherë njëri prej tyre i hap të gjitha bravat. Gido bën premtim: s’ka për të pirë më cigare që nga momenti kur do të bëhet diamant. Dhe gjithë publiku ja uron atij këtë moment. Kurse tani i uron vetvetes darkën. Dhe në restorant na pret një banket i vërtetë. Në tryeza të gjata janë shtruar lloje të ndryshme ushqimesh të shijshme, çfarëdo që mund të imagjinosh që nga sallatat ekzotike, peshqit e freskët dhe mishrat e pjekur deri tek garniturat e veçanta me perime dhe ëmbëlsirat e mrekullueshme. Do ishte më mirë të ishin vetëm gjysma e këtyre, sepse është e pamundur të zgjedhësh! Shqetësimi ynë zgjidhet nga sasia e pafund e birrës, verës dhe pijeve freskuese – natyrisht deri nesër, pasi vetëm pak gjumë dhe vjen mëngjesi i bollshëm...



## 26 QERSHOR, E SHTUNË

Pas zgjimit disa shkojnë të përgjumur për të ngërnë mëngjes, kurse të tjerë kthehen pas notit në det me peshqir në qafë. Asnjë anëtar i Forever-it nuk shihet vetëm, por në grupe të vogla duke biseduar. Pas drekës apo shikimit të ndeshjes dhe birrave në mbrëmje pijnë kafe së bashku në verandë. Po natyrisht, pasi Poreçi pikërisht për këtë bën fjalë: të jemi së bashku, më mirë dhe ndryshe nga deri tani – duke i kushtuar vëmendje vetëm njëri tjetrit. Tek autobusat – si çdo mëngjes – i pari është Dr. Sandor Mílesz me njerëzit e tij: ndodhet në fillim, tregon rrugën, jep shembull. – Të ngrej dorën ai që i pëlqen shumë para! – kjo thirrje na bëhet në sallën e leksioneve. Ditë e re, vrull i ri të cilin e marrin nga soaring manexheri **Tamas Budai**. Por siç thotë ai, Forever nuk bën fjalë vetëm rreth parasë: - nuk duam vetëm





### Istvan Halmi, safir menaxheri

“Të japësh leksion këtu është ndryshe nga vendet e tjera, sepse këtu ndodhet kremi, këtu çdo lektor dëshiron të jetë më i mirë se të tjerët: frymëzohemi nga të tjerët. Natyrisht pikësynimi është bashkimi i skuadrës: këto katër ditë na bashkojnë fort, sepse për këtë nuk nevojitet gjë tjetër veçse pikësynime të përbashkëta dhe komunikim.”



të mbushim me para xhepat e njerëzve, duam të sjellim në rregull jetën e tyre – shprehet Tamas Budai. Vjen një njeri, më bindshëm nga e cila janë të paktë ata që mund t’i transmetojnë këto vlera, dhe megjithëse menaxherja **Eva Varadi** është akoma shumë e re, rezultatet e saj të deritanishme premtojnë për më shumë. Ajo e quan veten e saj: “Produkt i Poreçit”. Pasi jo shumë kohë më parë këtu morri një shtytje shpirtërore dhe emocionale e cila e ngjiti në majë në krahasim me moshatarët e saj. “Që këtu u ktheva në shtëpi duke qenë menaxher në mendje” – kujton fillimet, pastaj tregon përkufizimin e saj të programit motivues NDP i cili u pëlqye shumë. Eva të jep përshtypjen sikur “u bë profesioniste me sy hapur”. Me tru racional, pa ndrojtje. Bleu makinë lluksoze duke qenë akoma studente – gjë e cila arrihet nga pak njerëz. Dhe meqë ra fjala rreth racionalitetit, të shohim faktet: safir menaxherja **Dr. Marija Ratkovic** flet rreth përvojave të saj me produktet dhe si menaxhere. – Pak njerëz mbajnë përgjegjësi për jetën e vet, por menaxheri i vërtetë nuk ja lë tjetrit përgjegjësinë dhe nuk lejon që të varet nga rrethanat. Është e rëndësishme të zotëroj vizion personal dhe në skuadër, pra të shikoj më larg se të tjerët – shprehet ajo. Mendimet vazhdojnë nga senior menaxherja **Agnes Klaj** e cila me stilin e saj të zakonshëm të ëmbël flet rreth ndihmës së dhënë nga sponsori dhe forcës së vendimit. – Merr vendim dhe përparo drejt pikësynimit! Qëllimi i një femre s’është tjetër, veçse t’u pëlqej të tjerëve dhe vetvetes. Për këtë na jep në dorë mjete të ndryshme **Tünde Hajcsik, Diana Biro dhe Patricia Rusak** në një Sonya show spektakolar. Femrat nxiten që „të guxojnë të mbeten femra pavarësisht nga mosha që përfaqësojnë”. Pastaj jo vetëm e dëgjojmë, por edhe e shikojmë, sepse – si gjithmonë – bëhet edhe prezantim në praktikë. – Unë e përdor prej dy vitesh, por s’kam gjetur më të mirë se kjo – tregon në sallë menaxherja Hilda Pere, dhe shton: nëse dikush e konsideron të shtrenjtë, këtu mund ta fitoj çmimin e saj! Arrijmë lartësinë e diamant-safirrit: në skenë shfaqet **Robert Varga**. Përpara kësaj luan puzzle pikërisht me Miklos Berkics: me skicën e leksionit të ndarë në copa të vogla. Siç shprehet, nuk ishte i kënaqur me versionin e parë. – Ne këto nuk i kemi lexuar, por i kemi bërë – shpjegon, dhe nga kjo gjë qetësohet. – Ndonjëherë vetëm në momentin e fundit,





kur do t'i referosh të bëhet e qartë se çfarë dëshiron të thuash në të vërtetë. Kur fillon e ka të qartë që: duhet të na bind ne të mos mundojmë vetveten me probleme financiare. Dhe dikur ai kishte shumë të tilla, por siç shprehet një pjesë e mirë e tyre ishin si pasojë e programimit negativ. Kurse sot e di që njeriu bën edhe gabime kur prodhon, prodhon dhe prodhon. Por si mund ta programojmë pozitivisht mënyrën tonë të të menduarit? Këtë na i tregon soaring menaxheri **Tomislav Brumec**. "Gjithçka zhvillohet në tru, nuk jemi krijesa trupore? – thotë. – Nëse je i ndershëm, të tillë njerëz do të tërheqësh pas vetes – premton ai. Në sallë shfaqet një njeri i cili njihet mirë dhe është shumë i preferuar, trainimi vazhdon nga safir menaxheri **Dr. Adolf L.**

#### **Jasmina Dragoljovic:**

"Hyra sivjet në mars dhe u bëra supervizore brenda 3 muajve. Dy javë më parë isha në Budapest me sponsorin dhe morra medaljen time nga Rex Maughan. Mezi i prisja leksionet dhe dje më bën aq shumë për vete, sa që gjatë darkës regjistrova edhe kamarierin në rrjet. Hyri pas punës dhe sot bëri blerje!"

#### **Tamas Kovacs dhe gruaja e tij, supervizorë:**

"Jemi për herë të parë në Poreç, por do të vijmë edhe herën tjetër. Sullëm me vete edhe fëmijën tonë 4 muajshe, është fëmijë e qetë, sillet mirë edhe këtu. As nuk na shkoi ndër mend ta linim Poreçin, pasi kemi akoma shumë për të mësuar."

#### **Dr. Goran Franjic, asistent menaxher, Bosnia-Hercegovina:**

"Poreçi e kam imagjinuar gjithmonë si një trainim të fortë që më ndihmon në punë. Morra përgjigje të shumta për pyetje për të cilat e vras mendjen prej kohësh, përshembull që si duhet të veprojmë nëse dobësohet jeta në rrjet, si i duhet dhënë ritëm i ri në mënyrë të thjeshtë dhe efektive."

**Kosa.** "Lexo, kupto, përdor" – na jep këshillën fitimprurëse, pastaj leksionin e tij e ndërton rreth shkronjës H e cila formon ekuilibrin dhe shkallën që të ngre lart. Dhe për këtë e falenderon. Për çfarë gjërash falenderon Adolfin? Në formë filmi shikojmë njëra pas tjetrës fotografitë e lluksit të marrë: rafting, kalorësim, zhytje, fuoristradë, shtëpi në Rozsadam me panoramë nga vaska... – E di çfarë ndjenje është frika nga vdekja? – Shumë eksituese – thotë në mënyrë të pabesueshme Adolf. Por nëse frika nga vdekja përbën pasionin ndaj sporteve ekstreme, atëherë e kuptojmë se për çfarë flet. – Është pak bezdi por ja vlen – thotë menaxheri – njëlloj si në këtë biznes. Po, në këtë biznes ku "ti mund të bëhesh më i miri" – ky është titulli i leksionit të senior menaxheres **Sonya Jurovic**. Ajo ka 11 vjet që punon pranë katër nipërve. Na rekomandon të fillojmë të besojmë në vetvete dhe të mësojmë "artin e dëshirave të mëdha": dëshiro gjithmonë një më shumë. Konkuro vetëm me vetveten. Ai që dëshiron të bëhet diamant, ka për t'u bërë i tillë!" – bën përmbledhjen. – Në botë një në njëzet milioner është pasuruar nga MLM-ja – thotë soaring menaxherja **Dragana Janovic** – në bazë të çfarë parimeve, këtë mund ta mësojmë tani: - në sistemin





### Laszlo Molnar, drejtori i FLP Kroacisë:

Kemi katër vjet që e organizojmë Holiday Rallyn dhe jemi shumë krenar që ndërmjet vendeve të FLP-s u zgjodh pikërisht vendi ynë. Në këtë periudhë na presin shumë punë mua dhe punonjësit e mi, por kur mbërrinjmë njëmijë e treqind mysafirë është gjithmonë një ndjenjë shumë e mirë. Duke u nisur nga ky vit Holiday Rally do të zhvillohet dy herë në vit, por kjo nuk përbën një punë të dyfishtë për ne, përkundrazi na përgjysohet puna, pasi kemi krijuar rutinë dhe nuk duhet të vemë në lëvizje shumë njerëz njëkohësisht: është më mirë kështu. Vendi i organizimit tani është shumë familjar, shumë njerëz thanë që u pëlqeu shumë shërbimi. Ne natyrisht kthehemi gjithmonë të lodhur në shtëpi, por kur për ditë me radhë na vijnë email-et falenderuese nga vende të ndryshme, kjo i jep një dimension tjetër lodhjes.



marketing gjendet gjithçka – thotë lektorja. – Nëse i kuptoni parimet bazë dhe i përvetësoni ato njëmijë përqind, ka për të funksionuar. **Safet Mustafic** nga supervisor u bë senior menaxher, tani morrim një pamje të shkurtër rreth kësaj rruge. – Zbuloni vlerat tuaja, sepse punoni me vetveten – këshillon Mustafic, i cili sipas dëshmisë së vet jeton një jetë të suksesshme e të lumtur. Dhe natyrisht punon për këtë: u vjen në ndihmë gjatë 24 orëve gjithë punonjësve të tij. Soaring menaxherja **Hajnalka Senk** tregon rreth një biznesi të ndërtuar me mjeshtri në një leksion të ndërtuar me mjeshtri. Pastaj shpjegon: - Këtu lektorët e tjerë e ngrenë nivelin e energjisë, unë s'kam detyrë tjetër veçse të bashkohem me ta. Pastaj skena ndriçohet nga një personalitet i fuqishëm:

**Lomjanski Veronika.** – Çfarë dëshiron të bëhesh dhe si dëshiron ta arrihesh atë: kjo është pyetja kryesore e dy ditëve – thotë ajo dhe shton: problemi është që të gjithë duan të bëhen menaxher dhe asnjëri nuk do të bëhet ndjekës. Por duhet t'i arrijmë të dyja nëse duam të fitojmë! Dhe ja ku është njeriu i cili ka fituar: diamant-safir menaxheri **Miklos Berkics.** – E kam të qartë detyrën time. Nuk e pres nga njeri tjetër. Më mirë marr njëmijë refuzime se sa të shkoj në hekurudhë. Edhe ti prandaj je këtu, që të bëhesh diamant dhe jo menaxher. Fillimisht në mendje, pastaj në vetvete. Unë kam besim tek diamanti im, por kam besim edhe tek diamanti i Arankës, Adolfit dhe Gidos. Dhe Miklos e tregon qartë që ky besim lëviz malet: ngrenë thesa me kripë bashkë me Adolf L. Kosa-n. Fillimisht Adolfi ngre në kurriz pesë duke qeshur. Pastaj vjen Miklos, salla hesht. Të gjithë janë të shqetësuar se mos e vë poshtë pesha sportistin me trup të madh. Dhe për një moment këmbët e Adolfit ngrihen mbi tokë. Miklos e mban në krahë në mënyrë stabile. Duartrokkitje të mëdha. Po, rreth kësaj bën fjalë ky biznes. Punonjësit mbajnë ngarkesat e njëri tjetrit, kështu që ato përgjysohen. Dhe këtu nuk llogariten dhuntitë. Mjafton të besojmë që do ta arrijmë! Dëgjohet kënga me titull Celebrate e Madonës, na kujtohen përsëri 13 vitet e kaluara dhe gjithçka që mund dhe ja vlen të festohet. Po, të festojmë edhe vetveten: s'është turp. Kjo është gjëja e parë që mësuam gjatë këtyre dy ditëve. Kërcim i përbashkët përpara skenës dhe në darkë vonë në gjithë sallat e hotelit Iluksoz të Poreçit – deri sa kemi fuqi.



# E dashur Shqiponjë e Re!

**T**ë përhëndes me respekt dhe dashamirësi Ty që në këtë verë hyre në një firmë të vërtetë botërore. Të përgëzoh për vendimin tënd! E di që mund të zgjidhje edhe nga produktet e firmave të tjera, mund të nisje biznes edhe në fusha të tjera ose me firma të tjera MLM – por ti je anëtar i vërtetë Forever-i. Tregoja pa frikë të gjithëve! Le të dëgjohet nga Budapesti deri në Vienë! Me siguri edhe ti e vure re që tani në Forever të gjithë flasin rreth ndonjë rally. Ai që nuk është në brendësi të botës së Forever-it më pyet shpeshherë që çfarë gare makinash zhvillohet këtu. Dhe unë u përgjigjem që këtu e kemi zakon të bëjmë rally në mënyrë tjetër. Rally ynë përfshin pushimet në Poreç, programet motivuese europiane dhe amerikane – por me të vërtetë ka ngjashmëri ndërmjet rallyt të zakonshëm dhe atij të Forever-it. Në të dy mund të marrin pjesë vetëm ata të cilët me punë të madhe individuale dhe në skuadër, si dhe me shumë praktikë arrijnë REZULTATE.

Rallyt bëjnë fjalë rreth dinamizmit, përparimit, dëshirës për të fituar, zhvillohen në vendet më të bukura të botës, pjesëmarrësit përkrahen nga shumë njerëz të cilët u gëzohen me të vërtetë sukseseve të fituesve – në të dyja llojet e aktiviteteve festohet puna e ndershme, vlerësohen dhe laudërohen më të mirët ngado që vijnë, të rinj apo përfaqësues të moshave më të vjetra, hungarez, sllav të jugut, shqipëtar, anglez, gjerman, suedez apo estonez.

Tek ne tani të gjithë po përgatiten për Holiday Rallyn e dytë, pushimet e Poreçit në fund të shtatorit (deri më 31 gusht mund ta arrish akoma kualifikimin e nevojshëm!). Madje pikët që siguron tani të llogariten edhe në Rallyn European. Jam i sigurt që edhe ti dëshiron ta shikosh Europën e madhe të Forever-it, si dhe Forever Hungarinë bashkë me rajonet e Europës juglindore në Vienë. Mblidh pikët, ke akoma pothuajse edhe tre muaj! Periudha e kualifikimit zgjat deri më 31 tetor të këtij viti.

Nëse je akoma fillestar, nivelin e parë (të paktën!) mund ta arrish edhe për argëtim. Një rendiment prej 20 pikësh brenda katër muajve. 5 pikë në muaj? Ti je i aftë për më shumë se kaq! Kjo është me të vërtetë mundësia e madhe e jetës tënde, që edhe si fillestar, duke arritur vetëm nivelin e parë, të marrësh pjesë në aktivitetin më të madh të Forever-it në Europë – **DREJT PËRDREJTË NË VIENË!**

Viena është afër. Ejani me tren ose katër veta me një makinë. Ndani shpenzimet e karburantit, ju bie vetëm disa mijëra forinta për njeri. Ndhimo të paktën 3 miqtë e tu që të kualifikohen dhe të vijnë me ne, me Ty. Në krahasim me vitet e mëparshme sivjet nuk shesim bileta hyrje për në Rally. Ai që nuk kualifikohet, nuk mund të vijë – për fat të keq nuk siguron një mbresë të përjetshme.

Arena e Vienës mban 12000 anëtarë të Forever-it. Pyet sponsorët dhe drejtuesit tuaj të sipërm, shiko njoftimet e Rallyt, bli për vete çdo muaj një Rally Box (kuti e vogël Touch) me vlerë 1 pikëshe, dhe zgjidh një **BLUZË RALLY MODERNE TË VEÇANTË**. Vishe me krenari, tregoje, fol shumë rreth saj, jepu mesazhin miqve të tu. Bluza nuk mund të sigurohet as me para, as falas – është pjesë e paketës Rally Box, pjesë dhe simbol i suksesit tënd european.



**Tibor Radoczki,**  
SOARING MENAXHER  
DREJTOR RAJONAL





## **A ekziston vend më i bukur për Ditën e Suksesit se sa Opatija? Jo. Dhe ky është vetëm fillimi!**

Drejtuesit e programit të Ditës së Suksesit të organizuar në hotelin Milenij në Opatija ishin Mirjana Katić Mesaroš és Tihomir Stilin. Zonja Katić është që nga fillimi anëtare e Forever-it. Bashkë me burrin e saj Ivan e kryejnë në mënyrë profesioniste dhe me shumë dëshirë këtë punë. Kurse Tihomir dhe gruaja e tij Maja arritën nivelin e senior menaxherit, dhe sot janë anëtarët më të suksesshëm të Forever-it në Kroaci.

Treguan shkurt rrugën që bëri firma jonë gjatë 32 viteve të kaluara – nga fillimi deri në ditët e sotme, kur jemi të pranihëm pothuajse kudo në botë. Pastaj kënduam bashkë me miqtë tanë të vjetër, grupin Maestral nga Opatija.

Mr. Sc. Laszlo Molnar përshëndeti punonjësit e ardhur nga çdo pjesë e vendit, si dhe mysafirët e dashur të ardhur nga vendet fqinje.

Lavdëroi distributorët kroat, pasi rezultati i punës së tyre të angazhuar është rritja e qarkullimit, shumë kualifikime të reja, dhe nëpërmjet kësaj shumë njerëz të kënaqur.

Senior menaxheri dhe inxh. i dipl. Ivan Ciler është një njeri i shumëanshëm i cili zhvillohet vazhdimisht. Inxhinier elektronik, përfaqësues i ushqimimit dhe mënyrës së shëndetshme të jetesës, i cili i njeh mirë bimët mjekësore.

Shpjegoi përse është më e mira pikërisht aloe e FLP-s, përse FLP është firma më korrekte MLM në botë, dhe njëkohësisht firma më e organizuar në Kroaci. Prodhimi dhe përpunimi që nuk dëmtojnë mjedisin, sigurimi i cilësisë, paketimi dhe rezervimi – të gjitha këto kontribuojnë në krijimin e pozitës drejtuese të tregut, ashtu si edhe çertifikatat ISO dhe HACCP, si dhe standardet e pastërtisë koser dhe halal.

Dominik Zvinec është vetëm katërbëdhjetë vjeç dhe i pëlqejnë shumë produktet tona, i preferuari i tij është First. Mbajti një leksion të pëlqyeshëm rreth formës së bidonit, përbajtjes dhe efekteve të produktit. Leksioni i tij i bindi të gjithë që Dominik në të adhmen do të ketë sukses në FLP.

Dr. Albert Keresztenyi, menaxheri i parë i Kroacisë dhe themeluesi i Fiume team të Rijekës, foli rreth detyrave tona në verë. Ushqimi i duhur, sa më pak kripë, shumë lëvizje dhe natyrisht përdorimi i produkteve FLP është çelësi me të cilin mund ta përgatisim organizmin tonë për ditët e nxeha. Dr. Keresztenyi foli edhe rreth gabimeve që kryejmë në lidhje me ushqimin dhe trajtimin e lëkurës. E dimë që ka raste kur sillemi keq me trupin tonë, e cila sjell shëndoshjen dhe problemet e lëkurës. Por e gjithë kjo mund të ndryshohet, vetëm duhet të ndryshojmë zakonet tona dhe duhet të kujdesemi

FOTOGRAFOI: Darko Baranašić





*Akoma më lart*  
*Success Day*  
*Opatija*  
*15 maj 2010*





më shumë për vetveten. Produktet që na ofron FLP-ja na vijnë në ndihmë për shumë gjëra. Përvojat me produkte të konsumatorëve u drejtuan nga senior menaxherja dhe kryeinfermerja nga Pula, Manda Korenić. Dëgjuaam përvojat e distributorëve të cilët i përdorin produktet prej shumë vitesh. Manda është gjithashtu konsumatore prej shumë vitesh, produktet tona i përdor me kënaqësi edhe në sallonin e saj kozmetik. Përvojat i plotësoi me këshillat e saj në mënyrë që t'i shfrytëzojmë me të vërtetë siç duhet mundësitë e ofruara nga produktet.

Ana Židan Laginja ndodhet në fillim të rrugës së saj në FLP. Tregoi historinë e saj duke vërtetuar faktin që momenti i vendimit të vërtetë është kur njeriu nis rrugën. Dhe ajo vendosi. Shpresojmë që së shpejti të jemi dëshmitarë të historisë së suksesit të saj.

Momenteve më të bukura të Ditëve të Suksesit i përket edhe kualifikimi i punonjësve tanë me rezultativ. Kualifikimi i asistent menaxherëve të rinj, supervisorëve të shumtë dhe distributorëve drejtues Top 10. Secili morri medaljen e merituar, pastaj bashkë me sponsorët e tyre festuan suksesin duke premtuar që ky është vetëm fillimi.

Zlatko és Sonja Jurović janë senior menaxherë të sapokualifikuar. Ky çift bashkëshortor është që nga fillimi anëtar i FLP-s. Jetën dhe punën e tyre të përbashkët ia kushtuan suksesit personal dhe të punonjësve të tyre. Gjatë punës së tyre shumëvjeçare Sonja dhe Zlatko mësuan prej gabimeve të veta, dhe tani na përcollën përvojat e tyre në mënyrë që ne t'i shmangim këto gracka.

Menaxherja nga Rijeka Jadranka Kraljić Pavletić në leksionin e saj motivues dhe entuziast foli rreth faktit se përse është mirë të jesh menaxher. – Na bën individ të shumëanshëm. Shfrytëzoheni atë që ju pëlqen, dhe hiqni dorë nga ajo që nuk ju pëlen – tha ajo. – Shfrytëzoheni kohën, sepse ajo punon për ne. Sa më shpejt e shfrytëzojmë, sa më shpejt e shikojmë veten në pasqyrë dhe e pranojmë vendimin që: po, unë këtë e dëshiroj, aq më shpejt nis vetë biznesin. Gjenero vetveten, vendosni, punoni, bashkohuni me njerëzit e mrekullueshëm të FLP-s – u tha të gjithëve Jadranka.

Agnes Krizso ishte ajo që regjistroi punonjësën e parë të Kroacisë. Një femër e jashtëzakonshme, e cila e merr seriozisht detyrën e saj dhe e kryen me angazhim të plotë. Si safir menaxhere na bëri të njohur programet dhe të drejtat e ofruara nga FLP. – Më e rëndësishmja është të ndihmojmë dhe të vlerësojmë njëri tjetrin, pasi vetëm askush nuk mund të ketë sukses – tha ajo. – Në radhë të parë mbajmë përgjegjësi ndaj vetvetes. Të kujdesemi për shëndetin tonë, të ruajmë fëmijët dhe prindërit tanë, pasi e ardhmja ndërtohet nga e shkuara. Planifimim, mendime pozitive dhe ndjekja e drejtuesve është rruga e suksesit. – mbylli mendimet e saj Agnes.

Pasi falenderoi lektorët dhe drejtuesit e programit mr. Molnar u dha medaljen me shqiponjë punonjësve që u kualifikuan në nivelin e asistent supervisorit dhe u uroi atyre që bashkë me ne të fluturojnë akoma më lart.

**mr. sc. Laszlo Molnar**  
**drejtori rajonal i FLP Kroacisë**







# Arti i menaxhimit

TAKIM MENAXHERËSH, ZLATIBOR, QERSHOR 2010

**Firma FLP sipas zakonit i mbledhi distributorët më të suksesshëm të Serbisë në malin Zlatibor, në një nga perlat më të bukura turistike të vendit. Në ambientin e mrekullueshëm të hotelit Mona në harmoni dhe mirëkuptim të plotë u miqësuam, mësuam dhe punuam. Vendosëm të hedhim një hap të ri të madh në zhvillimin e mëtejshëm të rrjetit serb.**



**P**as punës së lodhshme na u dha mundësia të njohim këtë mjedis të mrekullueshëm, të vizitojmë shpellën e Potpeçit e cila mbahet si një nga më të bukurat e Serbisë. Ishte një mbresë e madhe për ne edhe vizita e fshatit etno Zlaku dhe fabrikës së qeramikës që ndodhen pranë Užice.

Qëllimi i leksioneve ishte dhënia e udhëzimeve, nxjerrja në pah e gabimeve të punës sonë të deritanishme, si dhe gjetja e rrugëzgjdhjes për të gjitha vështirësitë e shfaqura në lidhje me ne, punonjësit tanë dhe rrjetin.

Pjesëmarrësit e takimit të menaxherit u përshëndetën nga drejtori rajonal i FLP Serbisë Branislav Rajić. Ai theksoi që

duhet të njohim vlerat tona personale dhe të mos dorëzohemi kurrë, pasi jemi drejtues dhe mbajmë përgjegjësi për veten dhe punonjësit taanë.

